



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 43, datë 26.03.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 3, 5 DHE 6 KATE MBI TOKË, ME 2 KATE
PARKIM NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “HAMDI SINA”, BASHKIA
TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Mema Invest” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 3, 5 dhe 6 kate mbi tokë, me 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Hamdi Sina”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Mema Invest” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi Nr. 19, datë 04.10.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 2, 4 dhe 5 kate mbi tokë, me 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Hamdi Sina”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Mema Invest” sh.p.k”, shfuqizohet.



5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 03.09/2025